

Përditësoni programin iOS në pajisjen tuaj iPhone, iPad ose iPod touch

Mësoni si të përditësoni pajisjen tuaj iPhone, iPad apo iPod touch sipas versionit të fundit iOS – me wireless ose duke përdorur iTunes.

Mund t’ a përditësoni pajisjen tuaj iPhone, iPad, apo iPod touch sipas vesionit të fundit të iOS me anë rrjetit wireless. Nëse nuk shikoni ndonjë përditësim në pajisjen tuaj, mund t’ a përditësoni atë manualisht duke përdorur iTunes.

Përpara një përditësimi

[Krijoni një kopje të përmbajtjes së pajisjes tuaj](#) duke përdorur iCloud ose iTunes.

Përditësoni pajisjen tuaj me anë të rrjetit wireless

Nëse shfaqet një mesazh që thotë se ka një përditësim, klikoni Install Now. Mund të ndiqni edhe këto hapa:

1. Vendosni në karikim pajisjen dhe [lidhuni me internetin nëpërmjet Wi-Fi](#).
2. Klikoni Settings > General > Software Update.



1. Klikoni “Download” dhe “Install”. Nëse mesazhi ju kërkon t’ i hiqni aplikacionet përkohësisht sepse iOS ka nevojë për më shumë hapësirë për përditësimet, klikoni “Continue” ose “Cancel”. Më vonë, iOS do t’ i ri-instalojë aplikacionet e fshira. Nëse klikoni “Cancel”, [mësoni se si duhet të veproni në vijim](#).
2. Për të përditësuar tani, klikoni “Install”. Ose mund të klikoni “Later” dhe të zgjidhni “Install Tonight” ose “Remind Me Later”. Nëse klikoni “Install Tonight”, vendosni pajisjen tuaj iOS në karikim përpara se të flini. Pajisja juaj do të kryejë përditësimin automatikisht gjatë natës.
3. Nëse ju kërkohet, shkruani fjalëkalimin. Në qoftë se nuk e dini fjalëkalimin, [mësoni se si duhet të veproni](#).

Nëse shikoni një gabim ose ju nevojitet më shumë hapësirë kur përditësoni me rrjet wireless


Nëse shikoni një mesazh gabimi, ndërsa përpiqeni të përditësoni pajisjen tuaj nëpërmjet rrjetit wireless, [mësoni se si duhet të veproni](#). Nëse ju nevojitet më shumë hapësirë për ndonjë përditësim me rrjet wireless, mund të [përditësoni duke përdorur iTunes](#) ose të [fshini materiale manualisht](#) nga pajisja juaj. Pavarësisht nëse po përdorni iTunes apo një rrjet wireless, hapësira e lirë në pajisjen tuaj pas përditësimit do të jetë e njëjtë.

Disa përditësimet të programeve iOS nuk ofrohen nëpërmjet rrjetit wireless. VPN ose lidhjet e ndërmjetme (proxy) mund t'a pengojnë pajisjen tuaj të kontaktojë me serverat e përditësimit të iOS-së.

Përditësoni pajisjen tuaj duke përdorur iTunes

Në qoftë se nuk mund të kryeni përditësimet nëpërmjet një rrjeti wireless në pajisjen tuaj iOS, mund të përditësoni manualisht duke përdorur iTunes nga një kompjuter i besuar (i sigurt). Nëse kompjuteri juaj përdor Hotspot Personal në një pajisje iOS që po përditësoni, lidhni kompjuterin tuaj me një rrjet tjetër Wi-Fi ose Ethernet, përpara se të kryeni përditësimin.

1. [Instaloni versionin e fundit të iTunes](#) në kompjuterin tuaj.
2. Lidhni pajisjen me kompjuterin.
3. Hapni iTunes dhe zgjidhni “[select your device](#)”.
4. Klikoni “Summary”, pastaj klikoni “Check for Update”.



5. Klikoni “Download” dhe “Update”.
6. Nëse ju kërkohet, shkruani fjalëkalimin. Në qoftë se nuk e dini fjalëkalimin, [mësoni se si duhet të veproni](#).

Nëse shikoni një gabim në iTunes ose ju nevojitet më shumë hapësirë për përditësimet

Kërkoni ndihmë nëse shikoni ndonjë [mesazh gabimi kur përditësoni pajisjen tuaj me iTunes](#). Ose nëse ju nevojitet më shumë hapësirë për një përditësim, mund të [fshini materiale nga pajisja juaj manualisht](#).